



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

RAPORT MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT BASHKISE BERAT PER VITIN 2018

Te nderuar keshilltare!

Në përputhje me nenin 48 te ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “ Per financat e vetëqeverisjes vendore”, Monitorimi dhe raportimi i zbatimit te buxhetit vendor”, nenit 65 te ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, nenit 9 pika 1.3 germa Ç, neni 34 pika 6, te ligjit 139/215 “ Per veteqeverisjen vendore” , Ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr.22 date 30.07.2018, po ju paraqesim raportin e trete te monitorimit te zbatimit te treguesve te buxhetit qe i perket periudhes 12 mujore 2018.

Ky buxhet mbeshetur ne parimin e transparences, parashikueshmerise, gjithepershirjes, etj, ka shprehur nevojat, kerkesat dhe pritshmërite e bashkëqytetarëve tanë, dhe besojme se është zbatim i përgjegjësive ligjore , detyrimeve dhe angazhimeve të marra përsipër nga Bashkia Berat.

Raporti i Monitorimit te Zbatimit te Buxhetit te vitit 2018 eshte i treti qe pergatit Bashkia Berat dhe informon keshillin bashkiak, raporti i pare informoi zbatimin e buxhetit per 4- Mujorin e Pare (Janar Prill 2018), raporti i dyte informoi keshillin bashkiak per 4- Mujorin e dyte Maj-Gusht 2018.

Raportimi i zbatimit te buxhetit eshte pergastitur ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Financave dhe Ekonomise nr.22 date 30.07.2018.

Bashkia Berat miratoi buxhetin e vitit 2018 me VKB nr.98 date 15.12.2017 dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr. 2052/1 date 22.12.2017, i cili me pas u dergua per celje prane deges se thesarit brenda afatit ligjor .

Me VKB nr. 16 date 16.02.2018 konfirmua nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr 468/1 date 20.02.2018, u miratua shtesa e buxhetit te bashkise per te ardhurat e trashguara nga viti 2017 ne vitin 2018, buxhet i cili u be efektiv prane deges se thesarit Berat.

Ndryshimet e buxhetit gjate vitit 2018 u vendimuar ne Keshillin Bashkiak me VKB nr.87 date 26. 07.2018 , konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr 2121/1 date 30.07.2018. Mbi bazen e ketij Vendimi plani i te ardhurave te bashkise u rrit me 22 346 000 leke (te ardhura nga qerate e banesave sociale si dhe te ardhura nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi).

- Total plani i te ardhura shkon ne 505 071 000 leke,
- Realizimi i te ardhurave eshte ne masen 333 490 000 leke
- **ose eshte realizua 66% e planit.**
- Mos realizimi ne vlere 171 580 000 leke ose 34 % e planit pa realizuar coj me mosrealizimin e planit te investimeve dhe te disa shpenzimeve operative.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Objektivi i përgjithshëm i buxhetit 2018 ishte: Menaxhimi korrekt i financave vendore, sigurimi i përdorimit të fondeve publike në respektim të parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit (**EEE**), **ne funksion të realizimit të misionit të bashkisë**, dhe në zbatim të VKB nr. 98 datë 15.12.2017, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe PBA Perfundimtare 2018-2020”.

Disa nga Objektivat e buxhetit 2018 :

- **Maksimizimi i** të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore, duke rritur ndjeshëm ato nëpërmjet shtimit të bazës (nr.) së taksapaguesve dhe jo nëpërmjet rritjes së nivelit të taksimit.
- **Forcimi i disiplinës fiskale**, duke respektuar rregullat dhe parimet e sanksionuara me ligj në hartimin, konsultimin, miratimin, zbatimin, raportimin dhe auditimin e buxhetit vendore, duke synuar një menaxhim të shëndoshë financiar.
- **Evidentimin dhe rregjistrimin real** të çdo taksapaguesi si dhe zbatimin e procedurave efektive për të thjeshtuar marrëdhëniet e tatimpaguesit me administratën tatimore vendore.
- **Rritjen e cilësisë** së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike, arsim dhe infrastrukturë rrugore në gjithë territorin e bashkisë në shërbim të përmirësimit të jetesës së qytetarëve.
- **Vijimin e investimeve** të nisura nga viti 2017 dhe shtimin sasior dhe cilësor të investimeve kapitale në vitin 2018 me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Bashkisë.
- **Rritjen e transparencës** në përdorimin e fondeve publike, dhe mirë administrimin e financave publike.
- **Ruajtjen e trendit rrites të raportit** midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale në favor të atyre kapitale;
Harmonizimin e kërkesave të komunitetit të dalë nga dëgjuesat publike me planet sektoriale të bashkisë dhe të ndermarrjeve dhe institucioneve në vartësi të saj.
- Ofrimi i shërbimeve në çdo Njësi Administrative në standartet dhe cilësinë e kërkuar.

Gjate zbatimit të buxhetit vjetor 2018 fokusi i punës sone ishte :

1. Likuidimi i detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga viti 2017;
2. Mbajtja nën kontroll të shpenzimeve duke mos rikrijuar borxhe të reja.
3. Mbyllja e vitit buxhetor 2018 pa detyrime të mbartura dhe krijim borxhi të ri.

Buxheti i Bashkisë Berat menaxhohet nga 7 Njësi Shpenzuese;

1. Bashkia Berat
2. Ndermarrja e Shërbimeve Publike
3. Ndermarrja e Gjelberimit
4. Drejtoria e Arsimit
5. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujrave dhe Shërbimit Veterinar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

6. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”

7. Qendra “Lira”

Ne pasqyren e meposhtme paraqitet realizimi i treguesve permbedhes te buxhetit per vitin 2018.

Ne 000/ leke

Nr	Pershkrimi	Buxheti fillesatar 2018	Buxheti rishikuar 2018	Realizimi 2018	Ne%
I	Totali i te ardhurave	1010163	1164990	993409	85.2
1	Total Transferta	527438	622349	622349	100
a	Transferta e pakushtezuar	277104	277104	277104	100
b	Transferta e pakushtezuar trasheguar nga viti paraardhes		52051	52051	100
c	Transferta Specifike	250334	250334	250334	
d	Transferta e Specifike trasheguar nga viti paraardhes		52859	52859	100
2	Total te ardhura te veta	482725	542641	371060	68.3
a	Te ardhura te veta	482725	505071	333490	66
b	Te ardhura te veta tarsheguar nga viti paraardhes	0	37570	37570	100
II	Totali i Shpenzimeve	1010163	1164990	879219	75.5
1	Totali shpenzime operative	772743	840636	709410	84.3
a	Shpenzime personeli	482096	493409	471455	95.5
b	Shpenzime operative, & mirembajtjes& te tjera transfert	290647	347227	237955	68.5
2	Shpenzime kapitale	237420	234354	169809	52.3

Sic shihet nga te dhenat e pasqyres se mesiperme, totali i te ardhurave eshte realizuar ne masen 85.2%, **te ardhurat lokale 66%**, (realizimi i te ardhurave sipas zerave eshte paraqitur nga drejtoria e te ardhurave).

Shpenzimet ne total jane realizuar 75.5%, zeri shpenzime personeli 95.5%, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes 68.5% Totali i shpenzimeve korrente 84.3%, shpenzimet per investime 52.3%, ndersa ne terren investimet jane realizuar sipas kontratave.

Sipas Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, neni 28, pika 5 , fondet e paperdorura te transfertes specifike ne fund te vitit buxhetor, trashegohen ne vitin buxhetor pasardhes ne te njejten funksion per te cilin jane dhene vitin e mbyllur buxhetor.

Persa u perket fondeve qe bashkia trashegon nga grandit dhe te ardhurat lokale ne shumen prej 114 189 622.24 leke , 93 % e tyre ose 106 393 000 leke jane fonde per te mbuluar investimet e tenderura dhe qe jane lidhur kontratat, ishin parashikuar per tu likujduar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

brenda vitit 2018. Keto mbeten pa likujduar per shkak te limitit te shpenzimeve qe u vendos ne thesar nga Ministria e Financave duke filluar nga data 07.11.2018. Limiti u cel pjeserisht ne daten 24.12.2018 vetem per shpenzimet operative.

Po keshtu per shkak te limitit mbeten pa u shlyer edhe detyrime per shpenzime korrente per cdo njesi shpenzuese.

NJESIA SHPENZUESE: BASHKIA BERAT

Menaxhon 47% te totalit te buxhetit te bashkise. Fondet jane planifikuar, alokuar dhe realizuar ne programet:

- ❖ Planifikim menaxhim administrim, perfshi fondin rezerve , emergjencen dhe kontigjencen, transferimin e kuotes se Kshillit te Qarkut , dhe transferta te tjera si Ndermarrjes UK, dhe Drejtorise Rajonale te Tatimeve.
- ❖ Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi,
- ❖ Sherbime publike vendore , pastrim qyteti she zona rurale, mirembajtje varrezash publike dhe te deshmoreve.
- ❖ Zhvillimi ekonomik
- ❖ Sporti dhe argetimi (transferta FK Tomori dhe Investime)
- ❖ Sherbime sociale.
- ❖ Banesa sociale
- ❖ Ujitja dhe kullimi (Investime)
- ❖ Transporti (Investime)
- ❖ Ujesjelleses kanalizime (Investime)
- ❖ Sherbimi shendetesor (Investime)
- ❖ Kultura dhe turizmi (Investime)
- ❖ Arsimi (Investime)

a. Programi i administrimit të përgjithshëm të bashkise (planifikim, menaxhim, administrim) Aparati I bashkise

Ky program parshikon manaxhimin financiar te Bashkise Berat dhe perfshin shpenzimet e nevojshme administrative per mbarvajtjen e punes ne permbushjen e funksioneve te percaktuara ne legjislacion.

Politika e Programit. Politika e këtij programi konsiston në përmiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë Berat, zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit te vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

Objektivat e politikës së programit:

- a) Fuqizimi i kapaciteteve te burimeve njerëzore ne Bashki ne menyre qe ti pergjigjen realizimit te vizionit dhe misionit te bashkise dhe ti pergjigjen standarteve me te larta qe kerkohen ne Qeverisjen Vendore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- b) Nxitja e sigurimit të shërbimit cilësor dhe me efektivitet ndaj qytetarëve.
c) Te ofroj një partneritet, koordinim dhe mirekuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale të punës në shërbim të komunitetit.

Produktet që synohen të ofrohen.

- a. Plotësim i 100% me nënpunës e punonjës i strukturës organizative të miratuar, në baze të politikave të përcaktuara për rekrutim, seleksionim dhe emerimin e punonjësve civilë, si dhe marrjen në punë të nënpunësve dhe punonjësve të tjerë.
- b. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe shërbimit për qytetarët.
- c. Funkcionim me efikasitet të plotë të Zyres me një ndalesë.
- d. Instalimi i sistemit të rrjeteve kompjuterike për administratën (përmirësim i sistemit të IT).
- e. Implementimi i sistemit PAV (platforma e administratës vendore) dhe krijimi i Regjistrisë Qendrore të personelit të administratës vendore. (përfutjes të projektit të financuar nga Fonde të Qeverisë zvicerane, Këshilli i Europës.)
- f. Shtrirja e Sistemit Informatik të Administrimit të Taksave (TAIS) edhe në njësitë administrative Roshnik, Sinje, Velabisht dhe Otlak. (për biznesin).
- g. Përmirësimi i sistemit të programit të administrimit të taksave vendore TAIS me elemente të tjera.
- h. Përmirësimi i produktivitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet dhe potencialin e tyre.
- i. Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime.

**PASQYRA E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE SIPAS
PROGRAMEVE BUXHETORE**

Në 000/ lek

Titulli	Emertimi Programit	Fakti i vitit paraardhës Viti 2017	PBA Plan Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	Fakti i Vitit 2018	Diferenca
01110	Administrata	178,442	192,731	192,731	218,043	162,036	56,007
10910	MZSH	30,322	34,955	34,955	37,954	29,588	8,366
10660	Zhvillimi ekonomik	0	890	890	890	0	890
08140	Sporti dhe arëtimi	42,300	50,000	50,000	50,530	46,030	4,500
06260	Shërbimet publike (Pastrim.....)	62,821	68,325	68,325	68,459	61,273	7,186
10430	Shërbimi Social	1,146	2,000	2,000	3,238	2,040	1,198
10660	Banësata Sociale	0	0	0	396	0	396



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

04240	Ujitja dhe kullimi	9,646	6,204	6,204	6,775	2,212	4,563
04530	Transporti	84,409	151,621	151,621	194,470	93,515	100,955
06370	Ujesjellesa e kanalizime	3,938	15,000	15,000	23,008	17,047	5,961
07330	Sherbimi shendetsor	0	3,000	3,000	3,000	2,106	894
08250	Kultura dhe turizmi	0	13,000	13,000	15,900	2,771	13,129
09120	Arsimi	0	10,995	10,995	17,113	7,390	9,723
	Totali Aparati	413,024	548,721	548,721	639,776	426,008	213,768

Realizimi i shpenzimeve ne total paraqitet ne masen 67% . Bashkia Berat (aparati administrativ) dhe sipas dy zërave kryesor (korrente, kapitale) krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente, plani vjetor 548 721 000 leke,
 plani rishikuar , 639 776 000 leke
 fakti realizuar 426 008 000 leke
 realizimi **67%**.

Totali i shpenzimeve per investime eshte realizuar ne masen ne masen 52.3 %, informacion i detajuar jepet aneksin nr.5, te kolona komente.

PASQYRA E REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE SIPAS NDARJES EKONOMIKE
NE PROGRAMIN PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM: 000/lek

Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	PBA Plan Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	Fakti i Vitit 2018	Diferenca	ne %
600	Paga	96,701	111,377	111,377	109,803	102,978	6,825	94
601	Sigurime Shoqërore	16,099	18,058	18,058	18,058	16,860	1,198	93
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	23,849	40,296	40,296	39,806	26,389	13,417	66
603	Subvencione	4,000					0	
604	Transferta Korente të Brendshme	3,440	2,500	2,500	2,500	1,981	519	79
605	Transferta Korente të Huaja						0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,657	11,000	11,000	16,165	1,103	15,062	7
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	146,746	183,231	183,231	186,332	149,311	37,021	80
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara	31,696	9,500	9,500	31,711	12,725	18,986	40
232	Transferta Kapitale						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	31,696	9,500	9,500	31,711	12,725	18,986	40
Totali	Shpenzime Kapitale	31,696	9,500	9,500	31,711	12,725	18,986	40
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)	178,442	192,731	192,731	218,043	162,036	56,007	74



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Sic shihet nga te dhenat e mesiperme shpenzimet ne total ne kete program jane realizuar ne masen 74% mosrealizimi ne vlere absolute prej 56 007 000 leke i perket zerit Transferta : Fondi rezerve, Fondi i emergjencave , Fondi kontigjences ,

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 94%, mosrealizimi me masen 8 023 000 leke, ose 6 %, si rezultat i vendeve vakant dhe procedurave te rekrutimit te punonjesve qe kan afatete caktuara, dhe mos perdorim te fondit vecante me perjashtim te shpebimit me rastin e daljes ne pension te punonjesve.

Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes jane realizuar ne masen 68%.

Jane likujtuar detyrimet e trasheguara nga viti 2017, jane shlyer rregullisht detyrimet ndaj te treteve si ndaj OSHEE, Ujesjelles kanalizimeve, shpenzimet telefonike dhe interneti. Jane kryer rregullisht pagesat e keshilltareve dhe kryetareve te fshatrave sipas listeprezencave te paraqitura deri ne muajin Tetor 2018.

Mosrealizimi ka te bej me moslikujdimin e faturave si dhe mospagesa e kryetareve te fshatrave dhe keshilltareve te muajve tetor dhe nentor per shkak te limitit te shpenzimeve e u vendos ne thesar nga Ministria e Financave duke filluar nga data 07.11.2018. Limiti u cel pjesisht ne daten 24.12.2018.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar aktivitetet:

- Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per nenpunesit dhe punonjesit e bashkise.
- Plotesimi i kerkesave per kushte normale te punes ne administrate nepermjet procedures se prokurimit per blerje dokumentacioni, kancelari, sherbim printimi, interneti.
- Sigurimi i materialeve dhe sherbimeve speciale, uniforma per policine bashkiake
- Realizimi i sherbimeve ndaj te treteve, OSHE, Ujesjelles, Telekom.
- Realizimi i shpenzimeve te transportit, blerje karburanti, pjese kembimi, siguracion mjetesh.
- Sigurimi i levizjes se nenpunesve dhe realizimi i shpenzimeve te transportit.
- Mirembajtja e mjeteve te transportit, pajisjeve te zyrave dhe vet ambienteve te zyrave nepermjet realizimit te shpenzimeve te, mirembajtjes se zakonshme.
- Realizim i i shpenzimeve per pritje percjellje.
- Realizimi i shpenzimeve te tjera operative.

Sherbimet publike (pastrim qyteti dhe zonat rurale, si dhe mirembajtja e varrezave publike dhe te deshmoreve) qe i perkasin programit **Sherbime publike vendore,**

Jane planifikuar 65 759 000 leke

Realizimi ne fakt 61 275 000 leke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Realizimi 93%, ne fakt, subjektet e kontraktuar per kryerjen e sherbimeve jane likujduar plotesisht kundrejt fatures se TVSH dhe situacionit te sherbimit te kryer.

Fondi rezerve, Fondi i kontigjences, fondit i emergjencave civile.

Bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 te ligjit nr. 9936, date 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësite të qeverisjes vendore, krijohet **Fondi Rezervë, i cili eshte perdorur me VKB.**

Per të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet **Fondi i Kontigjences.** Te dy këto fonde miratohen në masën deri ne **3 (tre) %** të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjences planifikohen per te përballuar situata emergjente. Ne zbatim te nenit 16 te ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 “Per Emergjencat Civile ” te ndryshuar, te nenit 29 te ligjit nr.139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, te pikes III/3 te VKM nr.329,date 16.05.2012, “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore”.Perdorimi i ketij fondi eshte bere me VKB.

Transferimi i fondeve kundrejt Futboll Klub “Tomori 1923”, jane planifikuar mujorin 27 530 000 leke, dhe ju eshte alokuar 23 476 000 leke, ose 85.2% e buxhetit te planifikuar. Eshte transferuar fondi kundrejt kerkeses se paraqitur per shpenzimet realisht te domozdoshme.

Artikululli 230-231 realizimi paraqitet ne masen 52.3 %, informacioni i detajuar jepet aneksin nr.5, te kolona komente.

Programi : MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPETIMI

Realizimi i shpenzimeve sipa ndarjes ekonomike paraqitet si me poshte:

000/ leke

Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	PBA Plan Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	Fakti i Vitit 2018	Diferenca	ne %
600	Paga	23,873	27,794	27,794	28,464	22,572	5,892	79.3
601	Sigurime Shoqërore	3,802	4,421	4,421	4,527	3,738	789	82.6
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,617	2,740	2,740	4,963	3,278	1,685	66.0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	30					0	
<i>Nen-Totali</i>	<i>Shpenzime Korrente</i>	<i>30,322</i>	<i>34,955</i>	<i>34,955</i>	<i>37,954</i>	<i>29,588</i>	8,366	78.0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Sic shihet nga te dhenat e mesiperme shpenzimet ne total ne kete program jane realizuar ne masen 78% mosrealizimi ne vlere absolute prej 8 366 000 leke.

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 80%, mosrealizimi me masen 6 681 000 leke mos perdorim te fondit vecante Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes jane realizuar ne masen 68%.

Jane likujduar detyrimet e trasheguara nga viti 2017, jane shlyer rregullisht detyrimet ndaj te treteve si ndaj OSHEE, Ujesjelles kanalizimeve, shpenzimet telefonike dhe interneti. Mosrealizimi ka te bej me moslikujdimin e faturave si dhe mospagesa e kryetareve te fshatrave dhe keshilltareve te myajve tetor dhe nentor per shkak te limitit te shpenzimeve qe u vendos ne thesar nga Ministria e Financave duke filluar nga data 07.11.2018. Limiti u cel pjesisht ne daten 24.12.2018.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar aktivitetet:

- Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per punonjesit e MZSH.
- Sigurimi i materialeve dhe sherbimeve speciale,
- Realizimi i sherbimeve ndaj te treteve, OSHE, Ujesjelles, Telekom.
- Realizimi i shpenzimeve te transportit, blerje karburanti, pjese kembimi, siguracion mjetesh.
- Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve.

NJESIA SHPENZUESE: NDERMARRJA E GJELBERIMIT

Menaxhon 3.5 % te buxhetit total . Fondet jane planifikar, celur dhe realizuar ne nje program: Sherbime publike vendore. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor te rishikuar, rezulton si me poshte:

Plani 12 mujorit,	41.236.000 leke,
Fakti 12 mujorit	37.894.180 leke
Realizimi	91 %.

Politika e këtij programi eshte permirësimi i kushteve mjedisore sa me te kendshem dhe funksionale, brenda standardeve bashkekohore, krijimit te nje ambienti shlodhes dhe qetesie ku qytetaret te kalojne nje pjese te kohes se tyre, duke nderhyre edhe ne blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti.

Objektivat e Programit :

- Mirembajtjen e struktures se siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure te gjelber.
- Shtimi i siperfaqeve te gjelberta duke shtuar mbjelljet me lule sezonale, siperfaqe me bar, mbjellja e pemeve dekorative etj.
- Mirembajtja e tendave dhe e pjergullave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- Mirembajtja e qoshkave dekorative, tavolinave dhe stolave ne te gjitha siperfaqet e gjelberta.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar produktet:

- Kryerjen e te gjitha proceseve teknologjike te punes si punim toke, vaditje, prashitje, krahsitje, plehrim, pastrim, grumbullim mbeturinash etj. ne nje siperfaqe te gjelber prej 93.203 m² ku nga kjo 16.804 m² eshte siperfaqe rruge e sheshe. 70.336 m² eshte siperfaqe bar (tapete), 4.821 m² siperfaqe lule.
- Mirembajtja e 467 stolave per te ofruar gjithmone vende shplodhjeje per qytetaret.
- Mirembajtje e gjithe inventarit te perfshire ne siperfaqet e gjelberta si, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicuesa, cezma zbukuruese, kende lojrash per femije, e kende argetuese per moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.

Mjellja me lule sipas sezoneve e 4821 m² siperfaqe lulesh.

Aktivitetet qe u realizuan

- Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per nenpunesit dhe punonjesit e Ndermarrjes se Gjelberimit, realizimi i planit 98 %. mosrealizim mbetet fondi i vecante ne masen 2%
- Realizimi i shpenzimeve operative ne masen 61 % te planit te 12 mujorit, u shlyen detyrimet e mbartura nga viti 2017 ne masen 1.042 mije leke. Per te cilat kishim fonde por nuk u likujduan per shkak te limitit te vendosur ne thesar jane shlyer rregullisht detyrimet ndaj OSHE, Ujesjells kanalizimeve , shpenzimet telefonike dhe internet si dhe shpenzimet e transportit. Mbetet pa realizuar nje fond prej 31 % ne vleren 2.913.000 lek te cilat i perkasin:
 1. Shpenzimet per blerjen e fidane peme, fare bari, fara lule dhe pleh organik dhe kimik. Per te cilen procedura e tenderimit u krye ne muaji dhjetor ne vleren 1.919.040 lek.
 2. Shpenzimet per Pesticide ne vleren 393.600 lek, kjo vlere nuk u likujduan per arsye te mbylljes se fondit limit nga dega e thesarit.
 3. Shpenzime per blerje karburant me vleren 543.188 lek, kjo vlere nuk u likujduan per arsye te mbylljes se fondit limit nga dega e thesarit.
 4. Shpenzimet nga te tretet uji, energji, internet te muajit dhjetor.
- Realizimi i investimeve paraqitet ne pasen 86 %, 14 % mos realizim i perket arsyes te paraqitjes se ofertave me te uleta.

Sipas ndarjes ekonomike paraqiten keta tregues te permblodhurte realizimit te buxhetit 000 leke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Emertimi i shpenzimeve	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan buxheti 12 mujor 2018	Realizimi i 12 mujorit 2018	% e realizimit
600+601	33316	33316	32978.5	98
602-609	7620	7620	4656.5	61
230-231	300	300	259	86
Totali	41236	41236	37894	91

DETYRIMET E PA LIKUIDUARA 2018						
Nr	Operatori	Nipt	Nr fatures	Data fatures e	Vlera	Objekti
1	GEGA CENTER SHPK	K66801001T	1035	5.10.2018	280674	Disel
2	ARDIT CEKA	L78319502A	34	21.11.2018	393600	Pesticide
3	GEGA CENTER SHPK	K66801001T	1259	5.12.2018	263214	Disel
4	BERNET	K73104009D	141	17.12.2018	4900	Internet
5	OSHEE			Dhjetori		Energji
6	UJESJ.-KANALIZIMI			Dhjetori		Uji

Per realizimin e aktiviteteteve te mesiperme u kryen 14 procedura prokurimi si me poshte:

Nr	Objekti Prokurimit	Tipi i Kontratës (mall/punë/shërbim)	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi limit me të cilin është shpallur procedura	Data zhvillimit të procedurës	Emri i Operatorit ekonomik/	Vlera e kontratës së nënshkruar	Organi që ka zhvilluar procedurën e prokurimit
1	Sherbim interneti	Sherbim	Kontrate	58,800	25.02.2018	BERNET	58,800	N. Gjelberimit
2	Veshje pune	Mall	Kontrate	203,250	11.04.2018	Gentian Sadiku	194,400	N. Gjelberimit
3	Materiale ndertimi	Mall	Kontrate	376,441	26.04.2018	ALVORA	359760	N. Gjelberimit
4	Mirembajtje vegla pune	Mall+pune	Kontrate	99,900	27.04.2018	Servis Droboniku	99900	N. Gjelberimit
5	Kancelari	Mall	Kontrate	83,167	27.04.2018	Ornela Dauti	83,167	N. Gjelberimit
6	Materiale zyre	Mall	Kontrate	18,300	27.04.2018	Ornela Dauti	18,300	N. Gjelberimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

7	Materiale pastrimi	Mall	Kontrate	66,500	30.04.2018	Marinela Bitri	66,500	N. Gjelberimit
8	Kondicionere	Mall	Kontrate	80,000	13.06.2018	Luan Xhafkollari	80,000	N. Gjelberimit
9	Materiale elektike	Mall	Kontrate	99600	26.06.2018	Ylli Koka	99,600	N. Gjelberimit
10	Morkorese motorshare	Mall	Kontrate	99000	27.06.2018	Neritan Lybeshha	99,000	N. Gjelberimit
11	Siguracion autometi	Sherbim+m all	Kontrate	67200	11.07.2018	SIGAL	67,200	N. Gjelberimit
12	Materiale hidraulike	Mall	Kontrate	99,680	20.07.2018	Ylli Koka	99,680	N. Gjelberimit
13	Pesticide	Mall	Kontrate	498,000	11.21.2018	Ardit Ceka	393,600	N. Gjelberimit
14	Fidane peme, plehra	Mall	Kontrate	1,990,800	07.01.2019	Ardit Ceka	1,919,040	N. Gjelberimit
Totali				3,840,639			3,638,947	

NJESIA SHPENZUESE ;NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Menaxhon 7.53% te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

1. Programi 4530: Mirembajtje rruges, trotuaresh sheshesh , kalldremesh, ndicim publik , sinjalistike rrugore, rrjetesh te kullimit te ujrave te bardha.
2. Programi 4520: Mirembajtje rruges rurale.

Realizimi i shpenzimeve sipas dy zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente,

Plani Vjetor	45 786 000 leke
Plani i 12 mujori 2018	45 786 000 leke
Fakti I 12 -mujorit 2018	39 634 209 leke
Realizimi ne %	86 %

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukture dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit te ndicimit publik. Mirembajtja e rrugëve rurale.

Objektivat e Programit

- Permiresimin e rrjetit ekzistues te rrugëve te asfaltuara, urbane dhe rurale që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve.
- Mirembajtjen e trotuare, kalldre ekzistuese si dhe shtimin e sipëfaqeve te reja.
- Mirembajtjen e rrjetit ekzistues te ndicimit publik dhe mundesimin e e krijimit te zonave te reja te ndricuara ne periferi te qytetit.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar produktet:

1. Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.

Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Gjatesia totale e rrugeve ne te gjithë teritorin e Bashkise Berat eshte 812 km, nder te cilat 624 km jane rruget rurale dhe 188 km jane rruget urbane.

Siperfaqja totale e rrugeve eshte 857 323 m² ne te gjithë teritorin e Bashkise nga te cilat 239 231 m² jane te trajtuara me asfalt dhe 618 092 m² me stabilizant.

Mirembajtje e urave 13 cope.

2.Mirëmbajtja e Rrugëve me kalldrem dhe trotuareve.

Mirmbajtja e rrugeve ekzistuese me kalldrem dhe shtimi i siperfaqeve te reja . Gjithsej kemi 80 942 m² qe do te mirmbahen.

3.Mirmbajtja e shesheve;

4.Mirmbajtja e sistemit te kanalizimeve te ujrave te bardha , te larta dhe i pusetave ne Njesine Administrative nr. 1 , nr. 2 , nr. 3 , Velabisht , Sinje , Otlak , Roshnik.

- Mirmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve te ujrave te bardha ne 830 zgara te vogla ekzistuese ne Njesite Admin. Nr. 1 , nr. 2 , nr. 3.
- Mirmbajtja dhe pastrimi kanalizimeve te ujrave te larta ne 30 zgara pritese te medha ne te gjithë teritorin e bashkise Parashikohet te vendosen zgara pritese per ujrat e larta 50 cope ne te gjithë teritorin e Bashkise.
- Pastrimi i perrenjve te meposhtem :
- Perroi i Kananit, Perroi i Lisit i Te Becit, Perroi i Suelasit , Perroi Pusi me Cati , Perroi i MCR,Perroi ne lagjen Nr.1

Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave , duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.

Mirëmbajtje Ndriçimi Rrugor.

Përfshihet mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët e qytetit dhe fshatrat , riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, qe kap nje gjatesi te ndicuar prej 37.89 km .

Mirmbajtja e rrugeve rurale te asfaltuara (Inventari i rrugeve sipas VKM nr 915 dt 11.11.2015)

Rruga Sinje – Velçan 8 km, Rruga K/ Dyshniku – Roshnik 1.1 km, Rruga Duhanas – Roshnik 8 km, Rruga K/Velabishtit – Starove 1.5 km, Rruga K/ Gjerovenit – Gjeroven 4 km, Rruga K/ Duhanasit – Duhanas 4 km, Rruga K/ Bilç – Malinat 18 km, Rruga Ure Vajguore – Veterik 3 km, Rruga K/ Lapardhase – Lumas 12 km, Rruga Berat – Sinje 22 km.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Sipas ndarjes ekonomike paraqen keta tregues te permbledhur te realizimit te buxhetit:

000/ leke

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 12-mujori Janar-Dhjetor 2018	Realizimi buxhetit Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	37984	37984	37254	98%
602-609	45922	45922	39770	86%
230-231	2 214	2 214	300	15%
Totali	86120	86120	77324	89%

Ndermarrja e Sherbimeve Publike, program 4530

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 12-mujori Janar-Dhjetor 2018	Realizimi buxhetit Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	35 545	35 545	34815	97%
602-609	43 585	43 585	37433	85%
230-231	2 214	2 214	300	13%
Totali	81 344	81 344	72 548	89%

Rruget Rurale, program 4520

Emertimi i shpenzimit	Buxheti vjetor 2018	Plan buxheti 12-mujori Janar-Dhjetor 2018	Realizimi buxhetit Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	2439	2439	2439	100 %
602-609	2337	2337	2337	100%
230-231	0	0	0	0
Totali	4776	4776	4776	100 %

Sqarojme ne menyre analitike si me poshte :

Artikulli 600+601, shpenzime personeli eshte realizuar ne masen 98%, mosrealizimi me masen 730 000 leke, ose 2 %, mos perdorim te fondit vecante. Jane derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimi mbi te ardhurat personale duke mos krijuar borxhe dhe deficit prane organeve tatimore.

Artikulli 602+609, shpenzimet operative dhe te mirembajtjes jane realizuar ne masen 8%.

(602) Shpenzimet operative (6020) Materiale zyre dhe te pergjithshme.

Eshte realizuar procedura e prokurimit blerje kancelari ne vleren 118998 leke,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

(6022) Sherbime nga te tretet.

Jane likujduar faturat e OSHE per periudhen Janar 2018 deri ne Nentor 2018 si dhe detyrimi I trasheguar nga viti 2017 ne vleren 2104404 leke.

Jane shlyer rregullisht faturat per vitin 2018 ne vleren 22858260 leke .

Jane shlyer faturat e ujit ne menyre te rregullt per vitin ne vazhdim.ne vleren 148553 leke

Jane shlyer faturat per sherbim internet 2018, duke lene pa likujduar muajin Nentor ,Dhjetor 2018 per arsye te vendosjes se limitit te fondeve nga Ministria.

(6023) Shpenzime transporti.

Ne zerin karburant kemi shlyer deyrimet nga viti 2017 ne vleren 1385382 leke si dhe jane shlyer faturat deri ne muajin Nentor 2018.ne vleren 5187601 leke. Kontrata e lidhur per vitin 2018 ka vleren 5249765 leke. Ka ngelur pa likujduar fatura me vleren 1120608 leke me date 13/11/2018.

Kemi shlyer nga viti I kaluar 2017detyrimin Pjes makine sherbime mjete ne vleren 2488469 leke. Per vitin 2018 kemi lidhur kontraten me vleren 2808000 leke.

Kemi likujduar nga kontrata e vitit 2018 vleren prej 996300 leke .

Kemi bere siguracionin e mjeteve te transportit ne vleren 143000 leke.

Eshte prokuruar dhe shlyer kontrata vajra makine ne vleren 298200 leke

(6025) Shpenzime mirmbajtje.

Ne zerin mirmbajtje jane likujdar detyrimet e vitit te kaluar 2017 ne materiale elektrike per mirmbajtje rrjeti elektrik ne vleren 1576014 leke. Eshte lidhur kontrata e vitit 2018 ne vleren 2700000 leke. Ka perfunduar kontrata conform ligjit dhe kushteve te kontrates me daten 17/08/2018. Nga kjo kotrate eshte likujduar vlera 1293609 leke dhe ka mbetur pa u likujduar vlera prej 1404231 leke.

Eshte lidhur kontrata per materiale ndertimi per vitin 2018 ne vleren prej 3511680leke dhe eshte realizuar dhe likuduar ne vleren 3136080leke. Ka ngelur vlera prej 375600 leke pa u likujduar nga kjo kontrate.

(6029)) Shpenzime te tjera operative

Jane shlyer detyrimet per shpenzime gjyqesore ne vleren 531500 lek . Per vitin 2018 kemi mbartur nje detyrim prej 7779727 leke . Kjo per arsye te fondit limit te vendosur ne thesar ne fond te vitit 2017. Ky detyrim eshte shlyer ne kater mujorin e pare te vitit 2018,duke i dhene prioritet faturave te prapambetura. Nga viti 2018 ka lindur detyrime si me poshte:

Faturat e shpenzimeve operative 602 dhe 231

Nr	OPERATORI	Nipti	Nr fatures	Date	Vlera e fatures	Objekti
1	OSHE Detyrim o prap.		2007-2018		9294942	OSHE detyrim ne vite
2	ALFAT	K04223404L	324	17/08/2018	18729	Materiale elektrike
3	ALFAT	K04223404L	325	17/08/2018	830400	Materiale elektrike
4	ALFAT	K04223404L	326	17/08/2018	444480	Materiale elektrike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

5	ABCOM	K11308001B		19/10/2018	4000	interneti Nentor 18
6	SARK shpk	K52531415H	84	5/11/2018	1106400	Ndertim muri
7	GEGA Center GKG	K66801001T	1183	13/11/2018	1120608	Gazoil
8	ABCOM	K11308001B		20/11/2018	4000	interneti Dhjetor
9	Albert Doku	K33710231Q	34	3/12/2018	666000	Zbukurimet feste.
10	Arsen Duro	K83018004I	90	19/12/2018	36000	Sherbim me vinc pema
11	EURO ALB SHPK	K66613407H	68	27/12/2018	375000	Materiale ndertimi

Artulli 230-231 realizimi paraqitet ne masen 15%, mosrealizimi 85% per shkak se nuk eshte likujduar akoma kontrata e lidhur per objektin “Ndertim muri”, e cila e shte lidhur ne dt 26/10/2018 me nr kontrate 374.me subjektin ‘SARK’ shpk, punimet kane perfunduar.

Shpenzimet korrente u kryen per te realizuar aktivitetet: Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per punonjesit e Ndermarrjes se Sherbimeve Publike.

- Plotesimi i kerkesave per kushte normale te punes ne administrate nepermjet procedures se prokurimit per blerje dokumentacioni, sherbim printimi,
- Sigurimi i materialeve dhe sherbimeve speciale.
- Realizimi i sherbimeve ndaj te treteve.
- Realizimi i shpenzimeve te transportit.
- Mirembajtja e mjeteve te transportit, pajisjeve te zyrave dhe vet ambienteve te zyrave nepermjet realizimit te shpenzimeve te, mirëmbajtjes se zakonshme.
- Realizimi i shpenzimeve te tjera operative.

Per realizimin e aktiviteteve te mesiperme u kryen 14 procedura prokurimi si me poshte:

REGJISTER PROKURIMESH				TE REALIZUARA					
						Vlera fituese			
Nr	emertimi I objektit	Nr Urdherit	Date	Vlera pa tvsh	Vlera me tvsh	pa tvsh	me tvsh	Personi	procedura
1	Vajra lubrifikante	1	23.01.2018	332750	400000	248500	298200	KAPPA OIL	Elektr



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2	Sherbim interneti	2	24/01/2018	43800	52560	40000	48000	ABCOM	Drejtdr.
3	Bojra per vijzime	3	8/5/2018	85000	102000	82600	99120	Jetnor Hoxhaj	Drejtdr.
4	Siguracion mjetesh	4	8/5/2018	144000	172800	143000	143000	SIGAI UNIQA	Elektr
5	Materiale elektrike	5	20/06/2018	2499700	2999640	2248200	2697840	ALFAT .SHPK	T I madh
6	Kancelari	6	27/08/2018	100000	120000	99165	119000	Polikron Ndoni	Drejtdr.
7	Blerje hekur	7	3/9/2018	100000	120000	98490	118188	Mark Calja	Drejtdr.
8	Ndertim muri	8	24/09/2018	1127500	1353000	922000	1106400	SARK shpk	T I madh
9	Vegla pune	9	24/09/2018	100000	120000	97525	117035	Ylli Koka	drejtdr.
10	Tabela sinjalistike	10	24/09/2018	100000	120000	97950	117740	Pupa.shpk	Drejtdr.
11	Materiale per zburim	11	12/11/2018	668450	802140	555000	666000	Albert Doku	Elektr .
12	Sherbime me vinc	12	19/12/2018	40500	48600	30000	36000	Arsen Duro	Sherbime
13	Disk preres asfalti	emergjent				20000		Ervin Luzi	emergjent
14	Gome fadrome	emergjent				40834	49000	Adriatik Caco	emergjent

**NJESIA SHPENZUESE :DREJTORIA E BUJQESISE, ADMINISTRIMIT
TE PYJEVE , UJRAVE DHE SHERBIMIT VETERINAR,**

Menaxhon 4.25 % te totalit te buxhetit te bashkise, ne programet:

- ❖ *Programi i Mirëmbajtjes së kanaleve ujitse dhe kulluese*
- ❖ *Planifikimit te mbrojtjes dhe shtimin e siperfaqes pyjore*
- ❖ *Programi i sektorit te bujqesise*

Emertimi i shpenzimit	Plan Buxhet vjetor 2018	Plan Buxhet 12/mujor 2018	Realizimi 12 mujor Janar-Dhjetor 2018	% e realizimit
600+601	22774	22774	20995	92
602-609	23671	23671	16795	71
230-231	2298	2298	2297	99
Totali	48743	48743	40087	82



